



Procesverbal 02/2023

I mbajtur në mbledhjen e II - të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e z.Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën 28.02.2024 në ora 10⁰⁰, në zyrën e takimeve të Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për Komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Njoftim nga ZKKK –ja infrastruktura në pjesët ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve, ku duhet të përmirësohet gjendja jo e mirë;
5. Planifikim për zhvillimin e vizitave në QMF dhe Qendrën e Fshatit Dubravë;
6. Koordinim për takimin me Drejtorin e infrastrukturës lidhur me kërkesat tona për infrastrukturë dhe
7. Të ndryshme.

Osman Emini, Kryesues i Komitetit për komunitete – Hapi mbledhjen e Komitetit për Komunitete dhe njofton me pikat e rendit të ditës të cekur më lartë.

Pika 2

Aprovohet Rendi i Ditës pa vërejtje

Pika 3

znj.Flora Abdullahu – Njofton anëtarët nga procesverbali i kaluar, Aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar me disa ndryshime.

Pika 4

Bekim Bajrami – ZKK-ja ka dëshirë të jetë pjesë e takimeve të zyrës për informim. Ka shumë projekte, mirëpo disa janë përfunduar, të jeni aktiv në këtë çështje për tu realizuar projektet të cilat janë të pa përfunduara. Në Lagjen Sallahane dhe Dubravë janë disa rrugë të pa përfunduara. Janë përfunduar rrugicat në Lagjen “Halit Ibish”, mirëpo ka edhe disa për tu rregulluar.

Osman Emini, Kryesues i Komitetit për komunitete – Të takohemi me drejtorin e infrastrukturës dhe të bisedohet për zhvillimin e punëve, drejtori është i hapur dhe të përgatitet kërkesa për MAPL-në dhe ministrinë përkatëse.

- Vizitë në QMF I dhe QMF II, të vizitohen dhe të shihet puna dhe shërbimet për komunitete se sa i marrin të gjitha shërbimet.

Flora Abdullahu – Të organizohet në dy javëshin e fundit të muajit dhe të vizitohet nga Komiteti për komunitete.

Xhemajl Jashari – Të vizitohet QKMF-ja dhe QMF 4 për shkak se frekuentojnë më shumë pjesëtarët e komuniteteve, për shkak se QMF II është në renovim.

Të ndryshme: Bekim Bajrami – Është një shqetësim në kohën e fundit për braktisjen e shkollës, deri tash ka qenë gjendje e kënaqshme, mirëpo tani është shqetësuese. Qëllimi kryesor i ZKK-së është shkollimi, problematika është në familje dhe jo në shkolla. Të organizohet një takim shoqëror me prind për të vazhduar shkollimi.

Osman Emini, Kryesues i Komitetit për komunitete – Të bëhet kërkesë për takim me prindër në zyret dhe të diskutohet me prindër të caktuar të tjerë përgjegjës.

Jeton Lika – A ka sjellje devijante apo braktisje të shkollës.

Bekim Bajrami - Ka edhe sjellje devijante edhe braktisje të shkollës.

Osman Emini, Kryesues i Komitetit për komunitete – Grupi për parandalim dhe braktisje kanë tentuar të bisedohet, mirëpo pa sukses. Në muajin Prill të planifikohet vizita në shkolla.

Bislim Kopili - Nxënësit marrin vërtetim nga shkolla për një muaj ose dy.

Procesmbajtësi,

Xh. Jashari

Xhemajl Jashari



Kryesuesi i Komitetit për komunitete

Osman Emini
Osman Emini